



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE  
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “BUJQËSI”**

**Niveli II në KSHK<sup>1</sup>, referuar niveli II në KEK<sup>2</sup>**

**Kodi: H-II-22**

**TIRANË, 2024**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të Kualifikimit profesional **“Bujqësi”, Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në të dy klasat e këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e arsimit të të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të individëve, me teste teorike apo praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

#### **A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e teorisë profesionale të integruar, në Kualifikimin Profesional **”Bujqësi”, Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në programet e përgjithshme të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të orëve të lëndëve profesionale, për të dyja klasat e marra së bashku (klasa e 10-të dhe klasa e 11-të).

**Lëndët profesionale** të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:**

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e bujqësisë	64	29
2	Bazat e blegtorisë	49	22
3	Kulturat bujqësore	72	32

4	Hyrje në teknologjinë bujqësore	37	17
	<b>TOTALI</b>	<b>222</b>	<b>100</b>

**Temat sipas lëndëve janë**

a) Temat nga lënda “**Bazat e bujqësisë**”, kl. 10-të dhe kl. 11-të; **Gjithsej 64 orë**

Tema 2	Kuptimi për ekosistemin dhe agroekosistemin	8 orë
Tema 4	Bima, mjedisi dhe streset mjedisor	10 orë
Tema 7	Proceset fiziologjike të bimëve	8 orë
Tema 8	Shumëzimi i bimëve	10 orë
Tema 9	Toka bujqësore, profili dhe elementet përbërës të saj	8 orë
Tema 14	Agroteknologjia e kulturave bujqësore	10 orë
Tema 2	Shërbimet në kulturat bujqësore	4 orë
Tema 5	Njohuri mbi sëmundjet dhe dëmtuesit e kulturave bujqësore	6 orë

b) Temat nga lënda “**Bazat e blegtorisë**”, kl.10-të dhe kl. 11-të; **Gjithsej 49 orë**

<b>Tema 6</b>	Llojet e kafshëve të fermës dhe rëndësia ekonomike e tyre	6 orë
<b>Tema 7</b>	Racat e kafshëve të fermës dhe drejtimi i prodhimit të tyre	5 orë
<b>Tema 13</b>	Klasifikimi ushqimit që përdoret për kafshët e fermës	4 orë
<b>Tema 16</b>	Kushtet klimatike për mbarështimin e shpendëve	2 orë
<b>Tema 18</b>	Mbarështimi bletëve	2 orë
<b>Tema 4</b>	Riprodhimi i kafshëve bujqësore	4 orë
<b>Tema 5</b>	Përkujdesjet ndaj kafshëve bujqësore para lindjes	4 orë
<b>Tema 11</b>	Konceptin e sëmundjes në kafshët e fermës	6 orë
<b>Tema 21</b>	Masat profilaktike në blegtori (dezinfektimi, deratizim dhe desinsektim)	4 orë
<b>Tema 22</b>	Higjiena e produkteve blegtorale	4 orë
<b>Tema 24</b>	Përpunimi tradicional i produkteve blegtorale	4 orë
<b>Tema 26</b>	Përpunimi i mbetjeve nga produktet blegtorale	2 orë
<b>Tema 27</b>	Përdorimit të teknologjive bashkëkohore (përfshirë TIK) në blegtori	2 orë

c) Temat nga lënda “**Kulturat bujqësore**”, kl. 10-të dhe kl. 11-të; **Gjithsej 72 orë**

<b>Tema 7</b>	Perimet e familjes solanore	7 orë
<b>Tema 8</b>	Perimet e familjes bostanore	6 orë
<b>Tema 9</b>	Perimet e familjes zambakore	5 orë
<b>Tema 10</b>	Perimet e familjes kryqore	5 orë
<b>Tema 23</b>	Kulturat e të lashtave	9 orë
<b>Tema 24</b>	Kulturat e të vonave	9 orë
<b>Tema 27</b>	Bimët aromatike dhe mjekësore	9 orë
<b>Tema 3</b>	Zhvillimi individual i pemëve frutore	6 orë
<b>Tema 7</b>	Shtimi vegjetativ me copa i pemëve frutore	8 orë
<b>Tema 8</b>	Shtimi me shartim dhe mënyrat e shtimit me shartim	8 orë

d) Temat nga lënda “**Hyrje në teknologjinë bujqësore**”, kl. 11-të; **Gjithsej 37 orë**

<b>Tema 2</b>	Makinat për punimin tokës	5 orë
---------------	---------------------------	-------

<b>Tema 4</b>	Makinat mbjellëse	5 orë
<b>Tema 5</b>	Makinat për përmirësimin ujqor të tokës	6 orë
<b>Tema 7</b>	Makinat për mbrojtjen e bimëve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Makinat për korrijen, shirjen dhe përpunimin e drithërave	8 orë
<b>Tema 11</b>	Makinat shpërndarëse të ushqimit në blegtori	4 orë
<b>Tema 12</b>	Makinat pastruese të stallave	2 orë
<b>Tema 13</b>	Makinat për përpunimin e mbetjeve organike	3 orë

### Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) orë dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i drejtimit/profililit të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

### Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

**Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve**

Nr	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Bazat e bujqësisë	29	17	7	7	3
2	Bazat e blegtorisë	22	13	5	5	3
3	Kulturat bujqësore	32	20	8	8	4
4	Hyrje në teknologjinë bujqësore	17	10	4	4	2
	<b>TOTALI</b>	<b>100%</b>	<b>60 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>12 pikë</b>

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundrejt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

<b>Pikët e fituara</b>	<b>Notat</b>
<b>0 - 14</b>	<b>4</b>
<b>15 - 21</b>	<b>5</b>
<b>22 - 29</b>	<b>6</b>
<b>30 - 36</b>	<b>7</b>
<b>37 - 43</b>	<b>8</b>
<b>44 - 52</b>	<b>9</b>
<b>53 - 60</b>	<b>10</b>

## **B. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Bujqësi", **Niveli II i KSHK, referuar niveli II në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr.</b>	<b>Kompetencat profesionale</b>	<b>Detyrat e punës</b>	<b>Pikët</b>
1.	Të kryejë procese të thjeshta pune të marrjes së mostrës së tokës për analizë.	<b>Detyra 1:</b> Kryerja e marrjes së mostrës së tokës për analizë pedologjike dhe agrokimike. – Hapja e profilit dhe marrja e mostrës së tokës për analizë pedologjike. – marrja e mostrës së tokës për analizë agrokimike.	<b>10</b>
2.	Të kryejë procese pune për prodhimin e fidanëve të kulturave perimore dhe drufrutore.	<b>Detyra 2:</b> Kryerja e proceseve të punës për prodhimin e fidanëve të kulturave perimore dhe drufrutore. – përgatitja e tokës për ngritjen e farishtes. – mbjell farën në farishte. – kryerja e procesit të ujitjes dhe	<b>25</b>

		<p>shërbimeve për prodhimin e fidanëve perimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kryen shartim me sytha dhe kalema.</li> <li>– kryen shërbime në shartësore.</li> <li>– klasifikimi, etiketimi dhe ruajtja e fidanëve të shartuar drufrutor.</li> </ul>	
3.	Të kryejë procese pune për kultivimin e bimëve të arave.	<p><b>Detyra 3:</b> Kryerja e proceseve të punës për kultivimin e bimëve të arave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– plehërimi bazë</li> <li>– përgatitja e tokës</li> <li>– mbjellja e farës dhe fidanëve</li> <li>– shërbime pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit.</li> <li>– Vjelja dhe ruajtja e prodhimit.</li> </ul>	<b>15</b>
4.	Të kryejë procese pune në blegtori.	<p><b>Detyra 4:</b> Kryerja e proceseve të punës në blegtori:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– përzgjedh ushqimet</li> <li>– ushqen kafshët në regjim stallor</li> <li>– ushqen ruminantët, monogastritët</li> <li>– ushqen pulat, bletët, peshqit.</li> <li>– kryen përgatitjet për mjeljen e kafshëve bujqësore.</li> <li>– kryen mjeljen me dorë ose mekanike të kafshëve bujqësore.</li> <li>– pastron lëkurën e trupit të kafshës.</li> <li>– kryen shërbime higjienike dhe klimatike në stallë.</li> <li>– kryen dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.</li> </ul>	<b>25</b>
5.	Të kryejë procese pune për përpunimin e thjeshtë të prodhimit foragjer.	<p><b>Detyra 5:</b> Kryerja e proceseve të punës për përpunimin e thjeshtë të prodhimit foragjer:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– pret/korr me krah, bar të njomë dhe jonxhë.</li> <li>– kryen operacione pune për tharjen e barit dhe jonxhës.</li> </ul>	15
6.	Të kryejë procese pune për mirëmbajtjen e makinave bujqësore.	<p><b>Detyra 6:</b> Kryerja e proceseve të punës për mirëmbajtjen e makinave bujqësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– përgatitja për mirëmbajtjen e makinerive bujqësore.</li> <li>– pastrimi, lubrifikimi.</li> <li>– mirëmbajtja dhe ruajtja e makinerive bujqësore.</li> </ul>	10
<b>Shuma</b>			<b>100</b>

## Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

### Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”. Provimi praktik do të kryhet në bazën prodhuese, kopshtin e shkollës ose fermat bujqësore dhe blegtorale pranë saj.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, qysh në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje *“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit dhe të ruajtjes së mjedisit”* gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënësi.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe veglave të punës etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t’u sigurohen pajisjet, materialet dhe veglat për realizimin e kësaj detyre.
- Nxënësit duhet t’i realizojë të gjitha detyrat.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërin prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë

parapakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.

- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

### **Udhëzime për realizimin e Detyrës 1: “Kryerja e marrjes së mostrës së tokës për analizë pedologjike dhe agrokimike”.**

Kjo detyrë do të realizohet në bazën prodhuese, kopshtin e shkollës ose fermat pranë saj.

Komisioni i provimit parapakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me punime për marrjen e mostrës së tokës për analizë pedologjike dhe agrokimike, në bazë të procedurës përkatëse.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me punime për marrjen e mostrës së tokës për analizë pedologjike dhe agrokimike, në bazë të procedurës përkatëse, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, marrjes së tokës për analizë, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t’a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve të punës.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale metër shirit, piketa, spango, bel, shat, qese, etiketa, skica, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

**Udhëzime për realizimin e Detyrës 2: “Kryerja e proceseve të punës për prodhimin e fidanëve të kulturave perimore dhe drufrutore”.** Kjo detyrë do të kryhet në bazën prodhuese, kopshtin e shkollës ose fermat pranë saj.

Komisioni i provimit parapakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me punime për prodhimin e fidanëve të kulturave perimore dhe drufrutore.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me punime për prodhimin e fidanëve të kulturave perimore dhe drufrutore, përgatitja e tokës për ngritjen e farishtes, mbjell farën në farishte, kryerja e procesit të ujitjes dhe shërbimeve për prodhimin e fidanëve perimor, kryen shartim me sytha dhe kalema, kryen shërbime në shartësore, klasifikimi, etiketimi dhe ruajtja e fidanëve të shartuar drufrutor si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit të punës.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t’a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.



Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve të punës.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale metër shirit, piketa, spango, farëra perimesh dhe frutash të ndryshme, vegla të thjeshta dore, pompa spërkatëse, plehra kimike, pesticide, dherishte, pleh organik, brisk shartimi, lidhëse, mastiç, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

### Udhëzime për realizimin e **Detyrës 3: “Kryerja e proceseve të punës për kultivimin e bimëve të arave.”**

Kjo detyrë do të realizohet në bazën prodhuese, kopshtin e shkollës ose fermat pranë saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përgatitjen e shtretërve për mbjelljen e farërave të imëta.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me punime për plehërimin, përgatitja e tokës, mbjelljen dhe shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit si dhe mbrojtjen e bimëve deri në marrjen e prodhimit bujqësor, vjelja dhe ruajtja e prodhimit. në bazë të procedurës përkatëse si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, të pajisjet vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve të punës.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale metër shirit, piketa, spango, farëra bimëve të ndryshme, vegla të thjeshta dore, pleh organik, makina mbjellëse, pompa spërkatëse, plehra kimike, pesticide, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

### Udhëzime për realizimin e **Detyrës 4: “Kryerja e proceseve të punës në blegtori”.**

Kjo detyrë do të realizohet në stallën e kafshëve që mund të ketë shkolla ose në fermat blegtorale pranë shkollës.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me të ushqyerit dhe kujdesin e kafshëve bujqësore.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me të ushqyerit dhe kujdesin e kafshëve bujqësore: përzgjedh ushqimet, ushqen kafshët në regjim stallor, ushqen ruminantët, monogastritët, pulat, bletët, peshqit, kryen mjeljen me dorë ose mekanike të kafshëve bujqësore, pastron lëkurën e trupit të kafshës, kryen shërbime higjienike dhe klimatike në stallë, kryen dezinfektimin e stallave dhe teritoreve të fermës në bazë të procedurës përkatëse, si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale, fermë për rritjen e kafshëve, tokë kullësorë, punishte ushqimi për blegtori, magazinë ushqimi, depo silazhi, tabela analitike të ushqimeve, tabela për nevojat ushqimore të kafshëve, ushqime të ndryshme, shatë, lopatë, krehër, karrocë, sfurk, dezinfektantë, peshqire, sapun, kova uji, mjete për fiksimin e kafshës, aparat mjelës, kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për mjeljen mekanike ndihmëse, kompleti i veshjes, makineri, pajisje dhe vegla të punës për largimin e plehut, krehër druri, furça, sfungjerë, dezinfektant kimik (kreolinë, sodë kaustike, klor, etj), gëlqere, pompa spërkatëse, pluhurose, flakëdhënëse, manuale ose katalogje për mjeljen e kafshëve, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 5: “Kryerja e proceseve të punës për përpunimin e thjeshtë të prodhimit foragjer”**.

Kjo detyrë do të realizohet në bazën prodhuese, kopshtin e shkollës ose fermat pranë saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përpunimin e thjeshtë të prodhimit foragjer.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me realizimin: pret/korr me krah, bar të njomë dhe jonxhë, kryen operacione pune për tharjen e barit dhe jonxhës, si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit. Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si: sipërfaqe e mbjellë me jonxhë, kosë, draper, kompleti i veshjes, manuale ose katalogje për operacionet e punës për tharjen e barit, pamje filmike të proceseve të punës

gjatë korrjes, kthimit, grumbullimit, si dhe të transportit të barit të thatë dhe të jonxhës, skica, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 6: “Kryerja e proceseve të punës për mirëmbajtjen e makinave bujqësore”**.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e parkut të makinerive bujqësore.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me mirëmbajtjen e makinave bujqësore, pastrimin, lubrifikimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e makinerive bujqësore.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me mirëmbajtjen, pastrimin, lubrifikimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e makinerive bujqësore si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t’u prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si: kompleti i veglave, veshje, graso, vajra, skica, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.